URDHËR
Nr. 69, datë 25.3.2026

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCAVE

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të neneve 28 dhe 29, të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"; të pikave 2 dhe 3, të nenit 11, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore"; dhe të ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003, "Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave",

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në periudhën 26 dhe 27 mars 2026, zëvendësministrit të Punëve të Brendshme, znj. Silva Caka.
2. Ngarkohet zëvendësministri i Punëve të Brendshme, znj. Silva Caka, për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I PUNËVE TË BRENDSHME
Besfort Lamallari